

Mazars Sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 – 22

Mazars sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	90,305,549	66,405,132
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	107,498,772	45,917,097
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	5,583,609	4,037,326
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,942,138	1,971,042
Shpenzime të shtyra dhe parapagime	8	43,165,507	30,037,460
Total aktive afatshkurtra		248,495,575	148,368,057
Aktive afatgjata			
Aktive financiare		12,143	12,143
Aktive afatgjata materiale	9	6,966,413	5,410,432
Aktive afatgjata jomateriale	10	1,254,287	-
Total aktive afatgjata		8,232,843	5,422,575
Total aktive		256,728,418	153,790,632
DETYRIME			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	39,199,024	1,364,098
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	4,073,495	971,442
Detyrime tatimore	13	24,004,492	21,982,109
Të ardhura të shtyra	14	58,043,655	48,258,327
Të tjera detyrime	15	51,721,089	37,294,274
Total detyrime afatshkurtra		177,041,755	109,870,250
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	16	9,358,323	18,031,624
Total detyrime afatgjata		9,358,323	18,031,624
Total detyrime		186,400,078	127,901,874
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva nga përkthimi		310,594	203,128
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		25,575,630	-
Fitimi i ushtrimit		44,332,116	25,575,630
Total kapitali		70,328,340	25,888,758
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		256,728,418	153,790,632

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mazars sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	251,941,470	193,055,147
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	561,550	25,336
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(63,866,218)	(45,018,664)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(53,946,695)	(29,772,573)
2) Të tjera shpenzime	21	(9,919,523)	(15,246,091)
Shpenzime të personelit	22	(134,989,479)	(116,177,281)
1) Paga dhe shpërblime		(128,502,580)	(110,419,186)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(6,486,899)	(5,758,095)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9/10	(1,364,306)	(1,709,485)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(781)	(8,719)
(Shpenzime)/të ardhura financiare neto	24	85,422	23,631
(Shpenzime) / të ardhura interesi			
1) dhe (shpenzime) / të ardhura të ngjashme		85,422	(4,090)
2) (Shpenzime) / të ardhura të tjera financiare neto		-	27,721
Fitimi/(humbja) para tatimit		52,367,658	30,189,965
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(8,035,542)	(4,614,335)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(8,035,542)	(4,614,335)
Fitimi/(humbja) e vitit		44,332,116	25,575,630
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		107,466	(226,127)
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		107,466	(226,127)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		44,439,582	25,349,503

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mazars sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva nga përkthimi	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	429,255	10,000	24,121,352	17,519,895	42,180,502
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	25,575,630	25,575,630
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	-	17,519,895	(17,519,895)	-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	(226,127)	-	-	-	(226,127)
Dividendë të paguar	-	-	-	(41,641,247)	-	(41,641,247)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	203,128	10,000	-	25,575,630	25,888,758
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	44,332,116	44,332,116
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	-	25,575,630	(25,575,630)	-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	107,466	-	-	-	107,466
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	100,000	310,594	10,000	25,575,630	44,332,116	70,328,340


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Mazars sh.p.k më 30 mars 2021 dhe janë firmosur si më poshtë.


Teit GJINI
Administrator

mazars

Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIIS: K32123006W


Bernard ÇUMASHI

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin operativ		
Fitim/(humbja) e vitit	44,332,116	25,575,630
Shpenzimet financiare jomonetare	952,066	372,862
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	8,035,542	4,614,335
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,364,306	1,709,485
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	-	(839,436)
Diferenca nga përkthimi asetëve	-	9,883
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(76,227,101)	(41,491,838)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	44,507,190	50,492,890
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	14,628,774	4,308,366
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	37,592,893	44,752,177
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve	-	(12,143)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata	(2,920,287)	(1,104,210)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	(1,254,287)	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata	-	1,493,564
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,174,574)	377,211
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(8,560,202)	(3,712,691)
Dividendë të paguar	-	(41,641,247)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(8,560,202)	(45,353,938)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	24,858,117	(224,550)
Diferenca nga përkthimi	107,466	(226,127)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	66,405,132	67,256,392
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(1,065,166)	(400,583)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 90,305,549	66,405,132

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Mazars" sh.p.k (ish-Gjini Consulting sh.p.k) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 13 qershor 2000 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria "Gjini Consulting" sh.p.k u bë anëtar plotësisht i integruar në partnershipin Global të MAZARS që prej datës 1 janar 2015, dhe që prej kësaj date emri i saj është "Mazars" sh.p.k.

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore me NIPT K32123006W.

Selia e shoqërisë është në Rr."Emin Duraku", Pall. "Binjaket", Nr 5, Kati i I-rë teknik, Ap. 1 dhe 2, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 3 kuota me vlerë nominale 100,000 Lekë.

Mazars Sh.p.k është një shoqëri shqiptare, e zotëruar nga ortakët:

- Z. Teit Gjini, zotërues i 1 kuote ose 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Zj. Irena Pulo, zotëruese e 1 kuote ose 5% të kapitalit të shoqërisë;
- Zj. Diana Ylli, zotëruese e 1 kuote ose 45% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Teit Gjini

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kryerja e shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC. Kryerja e shërbimeve të mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore, hartimi i pasqyrave financiare etj.

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 39 punonjës (2019: 33 punonjës).

Shoqëria "Mazars" sh.p.k, më 1 janar 2018, ka hapur degën e saj në Kosovë me nr. Fiskal 810872342 dhe nr. TVSH 330341777. Selia e shoqërisë Mazars – Dega në Kosovë është në Rr. Pashko Vasa, nr. 45/6, Prishtinë.

Drejtor i degës së shoqërisë në Kosovë është Zj. Violeta Haxhillazi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, monedhën shqiptare, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Eur/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64
CHF/LEK	114.46	112.30

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %
Aktive afatgjata jomateriale	Lineare	15 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.8. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerre

3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	88,259,261	59,152,108
Llogari rrjedhëse	88,259,261	59,152,108
Mjete monetare në arkë	98,350	670,105
Nëntotali	88,357,611	59,822,213
Mjete monetare Dega Kosovë	1,947,938	6,582,919
Totali	90,305,549	66,405,132

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogari të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	114,497,361	50,460,367
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(7,000,000)	(7,000,000)
Nëntotali	107,497,361	43,460,367
Klientë dega në Kosovë	1,411	2,456,730
Totali	107,498,772	45,917,097

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja më fillim të vitit	(7,000,000)	(7,000,000)
Provizionuar gjatë vitit ushtrimor	-	-
Rimarrje gjatë vitit ushtrimor	-	-
Gjendja në fund të vitit	(7,000,000)	(7,000,000)

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme nga Mazars scrI	145,203	-
Të arkëtueshme nga Mazars LLP	37,110	-
Të arkëtueshme nga Mazars Ltd, Cyprian Bumann	-	365,310
Të arkëtueshme nga Mazars Kosova Shpk	5,401,296	3,672,016
Të arkëtueshme nga Mazars Kosova	-	6,599,867
Të pagueshme nga Mazars Kosova	-	(6,599,867)
Totali	5,583,609	4,037,326

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të tjera	1,751,787	1,944,121
Nëntotali	1,751,787	1,944,121
Të tjera Dega Kosovë	190,351	26,921
Totali	1,942,138	1,971,042

8. Shpenzime të shtyra dhe parapagime

Shpenzime të shtyra dhe parapagime më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	11,404,856	6,299,420
Parapagime	31,760,651	23,738,040
Nëntotali	43,165,507	30,037,460
Parapagime dega në Kosovë	-	-
Totali	43,165,507	30,037,460

Mazars Sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Aktive afatgjata materiale Kosovë	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,623,364	4,892,005	5,364,855	3,134,970	15,015,194
Shtesa	-	146,733	957,477	-	1,104,210
Diferenca nga përkthimi	(129,800)	-	-	-	(129,800)
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,493,564)	-	-	-	(1,493,564)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	5,038,738	6,322,332	3,134,970	14,496,040
Shtesa	-	-	2,123,432	796,855	2,920,287
Diferenca nga përkthimi	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	5,038,738	8,445,764	3,931,825	17,416,327
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	657,628	3,404,582	2,706,295	1,590,397	8,358,902
Amortizimi i vitit	301,725	335,137	742,010	307,187	1,686,059
Diferenca nga përkthimi	(119,917)	-	-	-	(119,917)
Nxjerrje jashtë përdorimit	(839,436)	-	-	-	(839,436)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	3,739,719	3,448,305	1,897,584	9,085,608
Amortizimi i vitit	-	295,010	706,450	362,846	1,364,306
Diferenca nga përkthimi	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	4,034,729	4,154,755	2,260,430	10,449,914
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	965,736	1,487,423	2,658,560	1,544,573	6,656,292
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	1,299,019	2,874,027	1,237,386	5,410,432
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	1,004,009	4,291,009	1,671,395	6,966,413

10. Aktive afatgjata jomateriale

	Programe	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	609,598	609,598
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	609,598	609,598
Shtesa	1,254,287	1,254,287
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,863,885	1,863,885
<i>Amortizimi akumuluar</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	586,172	586,172
Amortizimi i vitit	23,426	23,426
Gjendja më 31 dhjetor 2019	609,598	609,598
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	609,598	609,598
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	23,426	23,426
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,254,287	1,254,287

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë vendas	39,191,165	574,481
Furnitorë të huaj	-	715,000
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	-	74,617
Nëntotali	39,191,165	1,364,098
Furnitorë Dega Kosovë	7,859	-
Totali	39,199,024	1,364,098

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	4,073,495	971,442
Nëntotali	4,073,495	971,442
Llogari të pagueshme tregtare Dega Kosovë	-	-
Totali	4,073,495	971,442

Mazars Sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***13. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	15,195,953	12,329,384
TVSH për t'u paguar	3,738,308	7,177,829
Tatim fitimi	3,690,308	1,289,786
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,030,369	828,530
Tatim në burim	347,453	36,508
Nëntotali	24,002,391	21,662,037
Detyrime tatimore Dega Kosovë	2,101	320,072
Totali	24,004,492	21,982,109

14. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagim nga klientë	58,043,655	48,258,327
Nëntotali	58,043,655	48,258,327
Parapagime Dega Kosovë	-	-
Totali	58,043,655	48,258,327

15. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera dhe më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj personelit	51,434,019	36,870,161
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	280,885	353,012
Nëntotali	51,714,904	37,223,173
Të tjera detyrime Dega Kosovë	6,185	71,101
Totali	51,721,089	37,294,274

16. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogari të pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Financim nga Ortakët	9,358,323	18,031,624
Totali	9,358,323	18,031,624

17. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100,000 Lekë i zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2020 dhe 2019:

Aksioneri	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuota	Vlera nominale	%
Teit Gjini	1	50,000	50%	1	50,000	50%
Irena Pulo	1	5,000	5%	1	5,000	5%
Diana Ylli	1	45,000	45%	1	45,000	45%
Totali	3	100,000	100%	3	100,000	100%

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shërbimet	251,338,719	171,044,910
Nëntotali	251,338,719	171,044,910
Të ardhura Dega Kosovë	602,751	22,010,237
Totali	251,941,470	193,055,147

19. Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhurat/(shpenzimet) e tjera të shfrytëzimit neto përfshijnë fitim/(humbjet) që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitime nga këmbimet valutore	2,161,968	1,167,307
Humbje nga këmbimet valutore	(3,114,034)	(2,831,603)
Të ardhura nga të tretët për vënien e ambjenteve në dispozicion	-	165,000
Të ardhura nga përkthime	1,229,247	709,383
Të ardhura të tjera	231,275	156,636
Nëntotali	508,456	(633,277)
Të ardhura Dega Kosovë	53,094	658,613
Totali	561,550	25,336

20. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Nënkotaktorë	41,665,388	18,910,331
Honorare dhe shërbime teknike	5,654,405	4,156,434
Qira zyra	2,733,720	2,955,940
Kuota IEKA, BMP	2,006,582	777,777
Shpenzime për përshtatje zyre	1,284,870	1,284,870
Shpenzime materiale konsumi	589,082	669,334
Nëntotali	53,934,047	28,754,686
Të tjera shpenzime Dega Kosovë	12,648	1,017,887
Totali	53,946,695	29,772,573

21. Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime utilitare dhe mirëmbajtje	2,037,310	1,635,016
Të ndryshme	2,036,489	1,265,764
Liçenca programesh kompjuterike	1,357,256	1,287,056
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	938,357	4,268,996
Shpenzime për pritje	811,112	2,495,755
Qira ambjenti	609,570	348,158
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	571,166	697,505
Prime sigurimi	468,643	347,190
Anëtarësime dhe abonime	446,535	392,804
Komisione bankare	229,372	263,522
Kontribut për të dëmtuarit nga tërmeti	3,000	367,740
Trajnime dhe kualifikime dhe rekrutime	-	261,996
Nëntotali	9,508,810	13,631,502
Të ndryshme Dega Kosovë	410,713	1,614,589
Totali	9,919,523	15,246,091

*(Vlerat janë në Lek)***22. Shpenzime të personelit**

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	128,285,993	105,959,424
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	6,486,899	5,716,710
Nëntotali	134,772,892	111,676,134
Shpenzime për personelin Dega Kosovë	216,587	4,501,147
Totali	134,989,479	116,177,281

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 39 (2019: 33).

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat, penalitetet dhe provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjopa dhe penalitete	-	7,847
Nëntotali	-	7,847
Të tjera Dega Kosovë	781	872
Totali	781	8,719

24. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto

(Shpenzime)/të ardhura financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	(1,047)	(5,383)
Të ardhura nga interesat	86,469	1,293
Humbje nga këmbimet valutore	-	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	-	27,721
	85,422	23,631

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	52,367,658	30,189,965
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	1,202,624	572,267
Shpenzime pritje dhe përcjellje	2,371	1,391,608
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	-	7,847
Shpenzime të panjohura Kosovë	29,490	23,437
Zbritur fitimi i tatueshëm i paguar në Kosovë	-	(1,624,875)
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullt tatimore	1,170,763	774,250
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	53,570,282	30,762,232
Tatim fitimi 15%	8,035,542	4,614,335
Fitimi i Vitit	44,332,116	25,575,630

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Balancat ndërmjet palëve të lidhura		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
Finacim nga Ortakët	9,358,323	18,031,624
Mazars s.r.o.	26,610	13,137
Mazars SCRL	367,389	840,213
Mazars Kft	-	7,488
MAZARS CONSULTING SRL	61,850	-
Mazars Slovensko sro	-	41,196
Mazars Actuariat	1,855,500	-
Mazars SA	3,525	69,408
Mazars LLP	1,758,621	-
	13,431,818	19,003,066
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Mazars Tax & Advisory S.R.L. STP	-	365,310
Mazars Kosova shpk	5,401,296	3,672,016
Mazars SCRL	145,203	-
Mazars LLP	37,110	-
	5,583,609	4,037,326

Mazars Sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***26. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)**

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Transaksionet ndërmjet palëve të lidhura		
Blerje nga palët e lidhura		
Mazars SCRL	6,922,434	4,705,517
Mazars KFT	201,144	497,741
Mazars SA	-	266,461
Mazars Polska SP ZOO	69,230	71,552
Mazars Actuariat	2,430,404	13,154,445
Mazars Cinotti Consulting D.O.O.	-	70,801
Mazars S.R.O.	132,426	132,962
Mazars Consulting Single Member P	-	682,526
MAZARS CONSULTING SRL	61,850	-
Mazars Slovensko S.R.O	798,344	334,538
Mazars LLP	2,226,040	-
	<u>12,841,872</u>	<u>19,916,543</u>
Shitje ndaj palëve të lidhura		
Mazars Cinotti Tax Consulting d.o.o.	-	68,574
Mazars Tax & Advisory S.R.L. STP	25,054	365,430
Mazars Kosova shpk	5,395,024	31,093
Mazars LLP	37,215	-
Mazars SCRL	145,531.44	-
	<u>5,602,824</u>	<u>465,097</u>

27. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

28. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare